



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 118/2013
Prishtinë, më 17.09.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N–302

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, kryetar, Teuta Sahatqija, Sala Berisha–Shala, Shaip Muja, Lutfi Zharku, Ramiz Kelmendi dhe Myzejene Selmani.

Munguan: Fikrim Damka, Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Etem Arifi.

Pjesëmarrës të tjerë: Fidaïm Sahiti, Ismet Shala dhe Alban Çollaku – MZHE; Burim Ejupi – INDEP dhe Gurjeta Zeka – praktikante.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.09.2013;
3. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik;
4. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2013;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas pikave të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 10.09.2013

Procesverbali i mbledhjes së datës 10.09.2013 u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me nismën legislative për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik

Kryetari – Tha se lidhur më këtë pikë jemi pajtuar që ta kemi sot, pasi që është paraparë në Planin e Punës të Komisionit për muajin shtator, që të fillohet me nismën legislative për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik. Dhe, për këtë e kemi ftuar z. Fidaim Sahiti, kryeshef ekzekutiv në Agjencinë Gjeologjike të Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, pastaj fjalën ia dha z. Sahiti.

Fidaim Sahiti, kryeshef ekzekutiv në Agjencinë Gjeologjike të Kosovës - Paraqiti një ekspozë të shkurtër lidhur më rëndësinë e shërbimit gjeologjik. Ai tha se është për t' u përshëndetur iniciativa e Komisionit parlamentar për nismën e hartimit të projektligjit për shërbimin gjeologjik. Me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për miniera dhe minerale është themeluar agjencia për shërbime gjeologjike, ku tani funksionon si agjenci brenda Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ai tha që duke u bazuar në përvojat e disa shteteve në rajon, që e kanë Ligjin për shërbimet gjeologjike edhe ne, si shtet, mund ta kemi një ligj për shërbimin gjeologjik që është në funksion të zhvillimit shkencor dhe ekonomik të vendit. Pastaj shtoi se nxjerrja e këtij ligji nuk ka implikime buxhetore, dhe në kuadër të shërbimit gjeologjik duhet të hyjë edhe shërbimi i sizmologjik i Kosovës.

Kryetari – Tha se nxjerrja e këtij ligji është ide e deputetes Sala Berisha – Shala. Qëllimi i ftesës, që i kemi bërë ministrisë dhe juve, si agjenci, është se a e ka në plan legjislativ Qeveria apo ministria nxjerrjen e një ligji të tillë dhe pse? Në Strategjinë legislative nuk është e paraparë një gjë e tillë dhe pyeti a keni ndonjë draft që keni punuar dhe a keni kapacitete të mjaftueshme që mund t'i asistoni komisionit në hartimin e projektligjit?

Fidaim Sahiti, kryeshef ekzekutiv në Agjencinë Gjeologjike të Kosovës - Tha se në Strategjinë legislative për vitin 2013 nuk është paraparë hartimi i Projektligjit për shërbimet gjeologjike. Ndërsa një draft i projektligjit ekziston në gjuhën angleze që nga viti 2005, pasi që nga atëherë kemi një rekomandim nga Shërbimi gjeologjik i Anglisë që këtë fushë ta rregullojmë më anë të Ligjit për shërbimet gjeologjike. Ai në fund shprehu gatishmërinë që do ta mbështesin grupin punues më tërë kapacitet që i ka Agjencia dhe ministria.

Sala Berisha – Shala - Tha pasi që Qeveria në bazë të Strategjisë Legislative për vitin 2013 nuk ka pasur këtë nismë, pra për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik, atëherë në si Komision jemi pajtuar që ta kemi në Planin e Punës për vitin 2013. Kërkoj që lidhur me nismën legislative për hartimin e projektligjit për shërbimin gjeologjik të formohet një grup i punues, po ashtu kërkoj nga përfaqësuesit e MZHE-së që ta mbështesin punën e grupit punues në aspektin profesional. Në fund propozoi që të shikohet mundësia që të realizohet edhe ndonjë vizitë në ndonjë shtet të rajonit për t'i marrë praktikatat e mira funksionimi dhe s'i është i rregulluar më Ligji shërbimi gjeologjik.

Komisioni, pas debatit nxori

V E N D I M

1. *Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri do të hartojë Projektligjin për shërbimin gjeologjik;*
2. *Themelohet grupi i punës në këtë përbërje: Sala Berisha – Shala kryesuese, Zenun Pajaziti, Lutfi Zharku, Shaip Muja, Visar Ymeri dhe Etem Arifi;*
3. *Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij Projektligji;*
4. *Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës gjatë punës së tij;*
5. *Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të hartojë Planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim për shqyrtim dhe miratim në Komision.*
6. *Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.*

4. Shqyrtimi i Planit të Punës të Komisionit për sesionin vjeshtor të vitit 2013

Kryetari i njoftoi deputetët se sekretaria e ka përgatitur draftin e Planit të Punës në bazë të Strategjisë legislative dhe aktiviteteve të tjera si monitorimi i ligjeve, vizitave në terren dhe organizimi i tryezave ose konferencave në bazë të fushëveprimit të Komisionit. Pastaj hapi debat.

Myzejene Selmani – Propozoj që Komisioni mos e vizitoj agjencinë e pavarur, por ata të vijnë dhe të raportojnë në Komision.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetes Myzejene Selmani.

Teuta Sahatqija – Kërkoi që në lidhje me Projektligjin për Dixhtalizimin e transmetimeve radiodifuzive dhe tokësore, të kemi bashkëpunim dhe konsultim me komisionin parlamentar për media, sepse kam informata se ata janë duke e shqyrtuar Strategjinë për Dixhtalizimin.

Komisioni u pajtua me propozimin e deputetes Teuta Sahatqija.

Ramiz Kelmendi – Tha se duhet të bëjmë vizita edhe të bizneset dhe t'i përfshijmë të gjitha kategoritë e tyre, ku do të njoftohemi për së afërmi më problemet dhe sfidat që përballen.

Pas debatit Komisioni nxori këtë

V E N D I M

1. *Miratohet Ndryshimi dhe Plotësimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013;*
2. *Plani buxhetor i Komisionit azhurnohet në përputhje me aktivitetet e parapara me Ndryshimin dhe Plotësimin e Planit të Punës së Komisionit për vitin 2013.*

5. Të ndryshme

Çështjet vijuese

Shaip Muja – Kërkoi përsëri që të ftohet në Komision për raportim znj. Mimoza Kusari –Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, lidhur me vendimin e marr për masat e ndalimit tregtar të mallrave nga Republika e Maqedonisë. Por kërkoi që edhe paraprakisht që ta dërgojnë edhe një raport zyrtar lidhur me vendimet që i kanë ndërmarrë MTI-ja deri me tani në lidhje me këtë çështje.

Kryetari – I njoftoi deputetët që e ka ftuar ministren në raportim, por për shkak të agjendës së saj të ngjeshur nuk ka arritur të vijë në raportim në Komision.

Komisioni u pajtua me propozimin e z. Shaip Muja që në mbledhjen e radhës të ftohet znj. Mimoza Kusari–Lila, ministre e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për raportim në Komision.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Zenun Pajaziti